



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Naser SAHITI

Nr. Prot.: 9/12
Datë: 29/12/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas Rregullores nr.1/775, dt. 9.9.2014 për studimet e doktoratës, Konkursit nr. 2/262 të datës 23.10.2020, për pranimin e studentëve në studime të doktoratës për vitin akademik 2020/21 si dhe Rekomandimit nr. 3/940, datë 22.12.2020, të Komisionit Qendror të Studimeve të Doktoratës, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.12.2020 mori këtë

V E N D I M

1. Aprovohen listat me kandidatët e propozuar nga këshillat e fakulteteve të renditura në pikën a), b), c) dhe d), me rekomandim të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës, për pranim në studime të doktoratës për vitin akademik 2020/21 në njësitë akademike si në vijim:
 - a) Fakulteti Filozofik;
 - b) FSHMN;
 - c) Fakulteti i Filologjisë; dhe
 - d) Fakulteti Juridik.
2. Me rekomandim të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës, për shkak të shkeljeve procedurale të konstatuara, refuzohen propozimet e Këshillit të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Mjekësisë.
3. Në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Mjekësisë, të përsëriten procedurat për organizimin e provimit pranues.
4. Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Mjekësisë të formojnë komisione të reja për organizimin e provimit pranues, në përbërje e cila nuk përjashton mundësinë e përfshirjes së përfaqësuesit ndërkombëtar të fushës përkatëse.
5. Obligohet zyra ligjore e UP-së të kërkoj opinion ligjor nga Avokati i Popullit dhe Agjencia Kundër Korrupsionit lidhur me mënyrën e trajtimit të rasteve të dyshuara për nepotizëm në konkursin për studime të doktoratës në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin i Mjekësisë.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë listat e kandidatëve të pranuar.

Arsyetim

1. Këshilli Qendror për Studime të Doktoratës (në tekstin e mëtejme KQSD), në mbledhjen e mbajtur me 18.12.2020, ka shqyrtuar raportet e gjashtë njërive akademike dhe listat e kandidatëve të propozuar për pranim në studime të doktoratës për vitin akademik 2020/21.
2. KQSD, gjithashtu ka shqyrtuar zbatimin e procedurave ligjore të konkursit dhe rregullores për studime të doktorates nga ana e njërive akademike përkatëse dhe mbi bazën e vlerësimit të dokumentacionit ka konstatuar se në katër njësi akademike të specifikuara në paragrafin 1 të dispozitivit të këtij vendimi, janë respektuar procedurat e përcaktuara sipas konkursit nr. 2/262 të datës 23.10.2020 dhe rregullores nr.1/775, dt. 9.9.2014 për studimet e doktoratës, ndërsa në

dy njësitë akademike të specifikuara në paragrafin 2 të dispozitivit të këtij vendimi ka gjetur lëshime të procedurave të konkursit dhe atë si në vijim:

- 2.1. Në Fakultetin Ekonomik: a) nuk është respektuar kriteri i përcaktuar sipas paragrafit 7 të pikës I të kushteve të konkursit nr. 2/262 të datës 23.10.2020, respektivisht pragu i kalueshmërisë është llogaritur ndaras me 50 % të pikëve nga provimi pranues dhe 50% të pikëve nga provimi i njërës prej gjuhëve të huaja, ndërsa ishte dashur të llogaritet 50% i pikëve të akumuluar nga provimi pranues, ku përfshihen edhe pikët nga njohuritë e njërës prej gjuhëve të huaja relevante për fushën e studimit; b) informimi jo i plotë i kandidatëve lidhur me kohën e mbajtjes së provimit pranues; dhe c) përgjigja në ankesat individuale të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 05/L -031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas së cilit arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, duhet të përmbajë, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.
 - 2.2. Në Fakultetin e Mjekësisë: a) nuk është respektuar kriteri i përcaktuar sipas nenit 7, paragrafit 4, alineja 4 e Rregullores nr.1/775, dt. 9.9.2014, për studimet e doktoratës, paragrafi 7 të pikës I të kushteve të konkursit nr. 2/262 të datës 23.10.2020, respektivisht kandidatëve nuk u është pranuar dëshmia për njohjen e një gjuhe të huaj botërore, relevante për fushën e studimit, përveç asaj angleze; b) disa kandidatëve përkundër arritjes së pikëve të nevojshme për pranim sipas rezultatit nga provimi pranues, kjo e drejtë u është mohuar pas publikimit të emrit në listën preliminare me arsyetimin se të njëjtit nuk e kanë dorëzuar një biografi me punimet shkencore të publikuara, dokument i cili nuk ka qenë i obliguar nëse kandidati nuk ka punime të publikuara dhe c) përgjigja në ankesat individuale të kandidatëve të cilët nuk janë pranuar nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 05/L -031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas së cilit arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, duhet të përmbajë, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.
3. Senati i Universitetit të Prishtinës mbështetur në argumentet e sipërshënuara dhe bazuar në Rekomandimin e KQSD-së, në mënyrë që përsëritja e procedurave për organizimin e provimit pranues të jetë sa më transparente dhe më e paanshme, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
 4. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit në ueb faqen e universitetit. Palët ankesat e tyre e drejtojnë në njësitë përkatëse akademike kurse njësitë akademike në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike përkatëse;
3. Menaxhmentit të UP-së;
4. KQSD-së;
5. Sekretarit të përgjithshëm;
6. Zyrës për Çështje Akademike dhe
7. Zyrës ligjore të UP-së.

